ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2024-2025

Shkolla Profesionale "Stiliano Bandilli" Berat

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1**: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025)** 8
Tabela 2: Periudha kohore në kërkim të një pune (2024-2025) 11
Tabela 3**:** Si e gjete punën tënde të parë? (2024–2025) 11
Tabela 4**:** Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025) 13
Tabela 5**:** Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025) 13
Tabela 6**:** Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025) 14
Tabela 7**:** Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024–2025) 17
Tabela 8**:** Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025) 18
Tabela 9**:** Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025) 18
Tabela 10**:** Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024-2025) 19
Tabela 11: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025) 20

Lista e figurave

Figura 1**: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)** 8
Figura 2: Vendbanimi i të diplomuarve (2024- 2025) 8
Figura 3: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 9
Figura 4: Punwsuar vs vetwpunwsuar (2024-2025) 10
Figura 5**:** Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2024-2025) 10
Figura 6**:** Kur e ke filluar punën tënde të parë? (2025) 11
Figura 7**:** Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025) 12
Figura 8: Lidhja punw arsim sipas drejtimit (2024-2025) 12
Figura 9**:** Niveli i pagave një vit pas diplomimit, net (2025) 15
Figura 10**:** Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024-2025) 15
Figura 11**:** Madhësia e kompanisë (2024-2025) 16
Figura 12**:** Lloji i kontratës (2024-2025) 16
Figura 13: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025) 17
Figura 14**:** Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024- 2025) 19

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Tabela e përmbajtjes 3
Gjetjet kryesore 5
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 6
Të diplomuarit 2024-2025 8
Analiza e rezultateve 9
Statusi i punësimit 9
Koha e gjetjes së punës së parë 10
Lidhja e punës me fushën e arsimit 12
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 13
Niveli i pagave 15
Kushtet e punës 15
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 17
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 18
Propozimet për përmirësim në shkollë 18
Planet për të ardhmen 19

Gjetjet kryesore


Ky raport krahasues paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës profesionale Stiliano Bandilli për vitet 2024 dhe 2025.

- Në vitin 2025, 94% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit, kundrejt 76.9% në 2024 me një rritje prej rreth 17 pikësh përqindje.
- Sipas drejtimit, në 2025 nivelet më të larta të punësimit u vunë re në SHMT, Termohidraulikë dhe Elektroteknikë (100% secili), ndjekur nga Mekanika (92%) dhe TIK (67%). Ndërkohw nw 2024, drejtimi me punësimin më të lartë ishte SHMT (100%), ndjekur nga Mekanika (80%) dhe Termohidraulika (50%).
- Në nivel të përgjithshëm, përqindja e të diplomuarve që deklarojnë se puna e tyre lidhet me fushën e arsimit u rrit nga 63.6% në 2024 në 78.4% në 2025, me një rritje prej 14.8 pikësh përqindje. Kjo tendencë përmirësuese vërehet edhe në nivel drejtimesh, si, Termohidraulikë shënoi ndryshimin më të theksuar, duke kaluar nga 0% e të diplomuarve me punë të lidhur me arsimin në 2024, në 71.4% në 2025. SHMT që kaloi nga 100% në 81.3% në 2025 mbi një bazë më të gjerë prej 16 të diplomuarish, ndërsa Mekanikë u rrit lehtësisht nga 75% në 81.8%. Drejtimi TIK, i pranishëm vetëm në të dhënat e vitit 2025, paraqiti një nivel përputhjeje prej 66.7%.
- Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara gjatë studimeve u rrit ndjeshëm: 79% e të diplomuarve në 2025 deklarojnë se i përdorin "shumë" ose "jashtëzakonisht shumë" në punën e tyre, kundrejt 45.5% në 2024.
- Paga minimale e referuar në pyetësor u rrit nga 40,000 lekë (2024) në 50,000 lekë (2025); në 2025, 59.4% e të diplomuarve raportojnë të ardhura deri në këtë prag. Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 59.4% paga minimale – 50,000 lekë, 18.8% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 12.5% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 3% nw fashwn 80,001 – 95,000 lekw, 6.3% nw fashwn 95,001- 120,000 lekw.
- Punësimi me kohë të plotë mbeti i lartë në të dy vitet, megjithatw ka njw rwnie tw lehtë nga 100% (2024) në 90.6% (2025).
- Perceptimi i sigurisë në punë, në 2025, 28% ndjehen "shumë të sigurt" dhe 40.6% "të sigurt", kundrejt 36.4% dhe 45.5% respektivisht në 2024; pjesa e atyre që ndjehen të pasigurt ra ndjeshëm, nga 18.2% (2024, "shumë të pasigurt") në 3% (2025, "të pasigurt").
- Në planet për të ardhmen, dëshira për një punë të lidhur me fushën e studimit u rrit ndjeshëm, nga 15.4% (2024) në 32.6% (2025), ndërsa dëshira për t'u punësuar thjesht (pavarësisht fushës) ra nga 38.5% (2024) në 13% (2025).

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.
Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **Stiliano Bandilli, Berat**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.
Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës krahasues pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i dy brezave të diplomuar në vitin 2024 dhe në vitin 2025 në shkollën Stiliano Bandilli.

Të diplomuarit 2024-2025

Në vitin shkollor 2023–2024, në shkollën Stiliano Bandilli u diplomuan 39 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2024–2025 u diplomuan 50 nxënës (Shiko tabelën 1).


*Tabela 1**: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025)***

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2023–2024	39	13	33%
2024–2025	50	46	92%

Nga të diplomuarit e vitit 2023–2024 u gjurmuan 13 nxënës (33%), ndërsa nga të diplomuarit e vitit 2024–2025 u gjurmuan 46 nxënës (92%), një përmirësim shumë i ndjeshëm i mbulimit të gjurmimit. Në brezin 2024, të gjithë të gjurmuarit (100%, N=13) ishin djem; në brezin 2025, pjesa dërrmuese e mbetën djem (45 nga 46, ose 97.8%), me vetëm 1 diplomuare femër. Për shkak të përfaqësimit shumë të ulët të femrave në kampion në të dy vitet, në vijim të raportit nuk paraqiten analiza krahasimore sipas gjinisë.

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve ndryshoi ndjeshëm mes dy viteve. Në 2024, 15.4% e të gjurmuarve i përkisnin drejtimit Termohidraulikë, 76.9% Mekanikë dhe 7.7% SHMT (N=13), pra kampioni mbështetej thuajse tërësisht te Mekanika. Në 2025, shpërndarja u diversifikua: 2.2% Elektroteknikë, 17.4% Termohidraulikë, 26.1% Mekanikë, 13% TIK dhe 41.3% SHMT (N=46), me SHMT-në tashmë si drejtimi më i përfaqësuar.


*Figura 1**: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)***



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Grafiku pasqyron shpërndarjen e brezit 2025 (N=46); për brezin 2024 (N=13).

Të pyetur lidhur me vendbanimin, në 2024, 100% (N=13) e të diplomuarve të gjurmuar jetonin në Shqipëri. Në 2025, 91% (N=42) jetonin në Shqipëri dhe 9% (N=4) jashtë vendit — një rënie e lehtë e qëndrimit në vend krahasuar me 2024.

Figura 2: Vendbanimi i të diplomuarve (2024- 2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza, 2024: N=13; 2025 (N=46).

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit 2023–2024, nga 13 të anketuar, 76.9% (N=10) ishin të punësuar/vetwpunwsuar, 7.7% (N=1) student/kursant, 7.7% (N=1) të punësuar e njëkohësisht student, ndërsa 7.7% (N=1) i dedikoheshin kujdesit për familjen/shtëpinë. Në brezin 2024–2025, nga 46 të anketuar, 94% ishin të punësuar/ tw vetwpunwsuar, ndërsa vetëm 2.2% (N=1) ishin student/kursant dhe 2.2% (N=1) të papunë një rritje e ndjeshme e nivelit të përgjithshëm të punësimit krahasuar me vitin paraardhës.


Figura 3: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=13; 2025 (N=46).

Krahasimi mes viteve 2024 dhe 2025 tregon një ndryshim të dukshëm në strukturën e punësimit të të diplomuarve. Përqindja e atyre të punësuar (me punëdhënës) ra nga 77% në 2024 në 63% në 2025, ndërsa përqindja e të vetëpunësuarve u rrit ndjeshëm, nga 0% në 2024 në 24% në 2025. Ky zhvillim sugjeron një zhvendosje graduale drejt vetëpunësimit tek pjesa e diplomuar në vitin 2025.


Figura 4: Punwsuar vs vetwpunwsuar (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=13; 2025 (N=46).

Në figurën 5 jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve. Në 2024, 50% e të diplomuarve në Termohidraulikë ishin të punësuar dhe 50% të punësuar e njëkohësisht studentë; 80% e të diplomuarve në Mekanikë ishin të punësuar, 10% vazhdonin studimet dhe 10% zgjodhën "tjetër" (N=10); i vetmi i anketuar nga SHMT (N=1) ishte i punësuar. Në 2025, niveli i punësimit sipas drejtimit ishte: Elektroteknikë, Termohidraulikë dhe SHMT 100% secili, Mekanikë 92%, dhe TIK 67% (me 17% të diplomuarve në TIK të punësuar e njëkohësisht studentë).

Figura 5: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2024-2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 sipas drejtimit: Termohidraulikë N=2; Mekanikë N=10; SHMT N=1; 2025 Elektroteknik= 1; Termohidraulikë N=8; Mekanikë N=12; SHMT N=19, TIK= 6.*

Koha e gjetjes së punës së parë

Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e të diplomuarve gjejnë punën e tyre të parë para diplomimit ose menjëherë pas tij, dhe kjo prirje mbeti e fortë në të dy vitet: 82% në 2024 kundrejt 72% në 2025, ndërsa pjesa tjetër raportoi periudha më të gjata pritjeje (1 muaj pas diplomimit ose 9–12 muaj pas diplomimit).

Figura 6: Kur e ke filluar punën tënde të parë? (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2025 N= 46.

Tabela 2: Periudha kohore në kërkim të një pune (2024-2025)

	2024	2025
Para diplomimit	81.8%	72%
1 muaj pas diplomimit	9.1%	16%
1 - 3 muaj pas diplomimit		6%
3 - 6 muaj pas diplomimit		6%
6 - 9 muaj pas diplomimit		
9 - 12 muaj pas diplomimit	9.1%	
Më shumë se 1 vit pas diplomimit		

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=13); 2025 (N=46)*

Lidhur me mënyrën e gjetjes së punës së parë (Shiko tabelën 3), kanali dominant ndryshoi ndjeshëm nga një vit në tjetrin. Në 2024, mënyra kryesore mbetej praktika profesionale në biznes (38.7%), e ndjekur nga njoftimet online/media sociale/gazetë (22.6%) dhe rrjeti personal (19.4%). Në 2025, kanali kryesor u bë qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë (47%), ndërsa praktika profesionale në biznes (22%) dhe rrjeti personal (19%) mbetën kanale të rëndësishme; pesha e njoftimeve online ra ndjeshëm (nga 22.6% në 6.3%).

Tabela 3: Si e gjete punën tënde të parë? (2024–2025)

Mënyra	2024	2025
Nga njoftimet për punë në internet, media sociale, gazetë	22.6%	6.3%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	19.4%	19%


Mënyra	2024	2025
Nga praktika profesionale në biznes	38.7%	22%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë punëdhënësin	6.5%	3%
Nga mësuesit	3.2%	-
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	9.7%	47%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=43).

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 63.6% (N=7) e të diplomuarve në 2024 dhe 78.4% (N=34) në 2025 u shprehën se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit, një rritje prej 14.8 pikësh përqindje. Në 2025, rreth 22% u shprehën që puna nuk lidhet, kundrejt 36.4% në 2024.


Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza 2024: N=13; .2025 (N=43). s*

Në lidhje me drejtimet dhe lidhja me arsimin, Termohidraulikë shënoi ndryshimin më të theksuar, duke kaluar nga 0% e të diplomuarve me punë të lidhur me arsimin në 2024, në 71.4% në 2025. SHMT që kaloi nga 100% në 81.3% në 2025 mbi një bazë më të gjerë prej 16 të diplomuarish, ndërsa Mekanikë u rrit lehtësisht nga 75% në 81.8%. Drejtimi TIK, i pranishëm vetëm në të dhënat e vitit 2025, paraqiti një nivel përputhjeje prej 66.7%.

Figura 8: Lidhja punw arsim sipas drejtimit (2024-2025)



Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (Shiko tabelën 4), të diplomuarit e brezit 2024 përmendën kryesisht pagën/kushtet më të mira të punës aktuale (50%) dhe pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (25%). Në 2025, e gjithë kjo pyetje u përgjigj me kategorinë "tjetër" (100%, N=9), pa arsye specifike të deklaruara.

Tabela 4: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025)

Arsyeja	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	25%	-
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	50%	-
Tjetër	25%	100%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=4); 2025 (N=9).

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (Shiko tabelën 5), 45.5% e të gjurmuarve në 2024 dhe 79% në 2025 pohojnë se i përdorin "shumë" ose "jashtëzakonisht shumë", një rritje shumë e ndjeshme (+33.5 pikë përqindje). Ndërkohë, pjesa e atyre që deklarojnë se nuk i përdorin "aspak" njohuritë e fituara ra nga 18.2% në 2024 në 9.3% në 2025.

Tabela 5: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025)

Viti	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	18.2%	-	36.4%	36.4%	9.1%
2025	9.3%	4.7%	7%	62.8%	16.3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=43).

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (Shiko tabelën 6), 54.5% e të diplomuarve në 2024 dhe 76.7% në 2025 e vlerësojnë këtë lidhje me "shumë/jashtëzakonisht shumë" (+22.2 pikë përqindje). Vlerësimet "aspak" u ulën lehtë, nga 27.3% (2024) në 9.3% (2025).

Tabela 6: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025)


Viti	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	27.3%	-	18.2%	45.5%	9.1%
2025	9.3%	2.3%	11.6%	55.8%	20.9%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=43).

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave, një vit pas diplomimit, shpërndarja e të diplomuarve ndryshoi mes viteve. Në 2024: 54.5% paguheshin deri në pagën minimale prej 40,000 lekë, 18.2% në fashën 50,001–60,000 lekë, 18.2% në fashën 60,001–80,000 lekë dhe 9.1% mbi 120,000 lekë. Në 2025: shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 59.4% paga minimale – 50,000 lekë, 18.8% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 12.5% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 3% nw fashwn 80,001 – 95,000 lekw, 6% nw fashwn 95,001- 120,000 lekw.

Figura 9: Niveli i pagave një vit pas diplomimit, net (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2025 (N=43).

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës, 100% e të diplomuarve në 2024 punonin me kohë të plotë, ndërsa në 2025 kjo pjesë ra lehtë në 90.6%.

Figura 10: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024-2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=11; 2025 (N=43);*

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas madhësisë së kompanisë, në 2024, 72.7% punonin në kompani me 1–4 punonjës, 18.2% me 5–9 punonjës dhe 9.1% me 10–49 punonjës. Në 2025,

mikrondërmarrjet (1–4 punonjës) mbetën mbizotëruese por u ulën në 59.4%, ndërsa 34.4% punonin në kompani me 5–9 punonjës, 3.1% në kompani me 10–49 punonjës dhe po aq (3.1%) në kompani me mbi 50 punonjës.


Figura 11: Madhësia e kompanisë (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=11; 2025 (N=43).*

Lidhur me llojin e kontratës, në 2024, 18.2% e të gjurmuarve kishin kontratë me afat të caktuar, 36.4% me afat të pacaktuar, 9.1% ishin në praktikë dhe 36.4% punonin pa kontratë. Në 2025, situata u përmirësua dukshëm në raport me kontraktimin formal: 53.1% kishin kontratë me afat të caktuar, 31.3% me afat të pacaktuar, dhe 15.6% ishin pa kontratë.

Figura 12: Lloji i kontratës (2024-2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=11; 2025 N=43.*

Lidhur me pagesën e kontributeve të detyrueshme nga punëdhënësi, 81.8% e të diplomuarve të punësuar në 2024 deklaruan se iu paguheshin, kundrejt 43.8% në 2025, një rënie e ndjeshme. Në 2025, 9.4%

deklaruan se nuk iu paguheshin sigurimet, ndërsa pjesa e atyre pa informacion mbi këtë çështje u rrit ndjeshëm, në 46.9% (kundrejt 9.1% në 2024).

Figura 13: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=11; 2025: N=43;*

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 36.4% e të diplomuarve në 2024 u shprehën se ndjehen "shumë të sigurt", 45.5% "të sigurt" dhe 18.2% "shumë të pasigurt". Në 2025, 28.1% u shprehën "shumë të sigurt", 40.6% "të sigurt" dhe vetëm 3.1% "të pasigurt", pjesa e atyre që ndjehen të pasigurt në punë u ul ndjeshëm mes viteve.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 54.5% e të diplomuarve në 2024 shprehen se ndjehen "shumë të kënaqur", 27.3% "të kënaqur", 9.1% "as të kënaqur as të pakënaqur" dhe 9.1% "shumë të pakënaqur". Në 2025, 37.5% ndjehen "shumë të kënaqur", 46.9% "të kënaqur", 12.5% "as të kënaqur as të pakënaqur" dhe 3.1% "të pakënaqur".

Tabela 7: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024–2025)

Treguesi	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	18.2%	-
I/e pasigurt	-	3.1%
As i/e sigurt as i/e pasigurt/ neutral	-	-
I/e sigurt	45.5%	40.6%
Shumë i/e sigurt	36.4%	28.1%
Shumë i/e pakënaqur	9.1%	-
I/e pakënaqur	-	3.1%
As i/e kënaqur as i/e pakënaqur/ neutral	9.1%	12.5%
I/e kënaqur	27.3%	46.9%
Shumë i/e kënaqur	54.5%	37.5%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=43).

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (Shiko tabelën 7), në 2024, 54.5% pohuan se shkolla i ka mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, 18.2% pohuan se i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, dhe 18.2% pohuan se i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë; 9.1% u shprehën se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në 2025, pesha e orientimit mbi mundësitë e punësimit u rrit ndjeshëm 53.5%, nga 18.2% në 2024, ndërsa mësimi i kërkimit/aplikimit për punë mbeti relativisht i qëndrueshëm nw 51.2%.

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025)

Lloji i ndihmës	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	54.5%	51.2%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	18.2%	53.5%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	18.2%	11.6%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	9.1%	-
Tjetër	-	4.7%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=46).*

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës (Shiko tabelën 8), në 2024 pothuajse të gjitha aspektet u vlerësuan me nevojë të lartë për përmirësim (nga 58.3% deri në 81.8%), me theks te bashkëpunimi me bizneset (81.8%), kurrikula (80%) dhe infrastruktura (77.8%). Në 2025, niveli i përgjithshëm i raportuar në shkallën "shumë/jashtëzakonisht shumë" ra ndjeshëm në pothuajse çdo aspekt, me përjashtim të bashkëpunimit me zyrat e punësimit me 32.6%, dhe teksteve/materialeve me 17.1%.

Tabela 9: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025)


Aspekti	2024	2025
Infrastruktura	77.8%	-
Kurrikula	80%	16.1%
Tekstet dhe materialet	63.6%	17.1%
Metodat e mësimdhënies	66.7%	-
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	58.3%	-
Praktika në shkollë	75%	3.8%
Praktika në biznes	63.6%	-

Aspekti	2024	2025
Këshillimi i karrierës	66.7%	-
Bashkëpunimi me bizneset	81.8%	-
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	66.7%	32.6%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=11); 2025 (N=46).*

Nëse do të kishin mundësi, 92.3% e të diplomuarve në 2024 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 84.6% të njëjtën shkollë. Në 2025, kjo dëshirë u rrit në maksimum: 100% do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim dhe 100% të njëjtën shkollë (shiko figurën 12).

Figura 14: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=13; 2025: (N=46).

Tabela 10: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024-2025)

		Termohidraulikë	Mekanikë	SHMT	TIK	Elektroteknikë
2024	Degë	100%	90%	100%		
	Shkollë	50%	90%	100%		
2025	Degë	100%	100%	100%	100%	100%
	Shkollë	100%	100%	100%	100%	100%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza 2024: N(Termohidraulikë)=2; N(Mekanikë)=10; N(SHMT)=1. Për 2025, Elektroteknik= 1; Termohidraulikë N=8; Mekanikë N=12; SHMT N=19, TIK= 6.*

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet e tyre për të ardhmen e afërt (shiko tabelën 10), dëshira për të filluar biznesin personal ishte prioriteti kryesor në 2024 (38.5%, e barabartë me dëshirën për t'u punësuar thjesht, gjithashtu 38.5%), ndërsa në 2025 prioriteti kryesor u bë gjetja e një pune të lidhur me fushën e studimit (32.6%, nga vetëm 15.4% në 2024). Dëshira për t'u punësuar pavarësisht fushës ra ndjeshëm, nga 38.5% (2024) në 13% (2025), ndërsa dëshira për të filluar biznesin personal ra lehtë, nga 38.5% në 28.3%. Dëshira për emigrim jashtë vendit dhe për migrim të brendshëm ranë të dyja, nga 7.7% (secila, 2024) në 2.2%

(secila, 2025), ndërsa interesi për studime të mëtejshme mbeti relativisht i qëndrueshëm (7.7% në 2024, 8.7% në 2025).

Tabela 11: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025)

Plani	2024	2025
Të jem punësuar	38.5%	13%
Të kem gjetur një punë që lidhet me fushën time të studimit	15.4%	32.6%
Të kem filluar biznesin tim	38.5%	28.3%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	7.7%	8.7%
Të kem emigruar jashtë vendit	7.7%	2.2%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	7.7%	2.2%
Tjetër	-	43.5%

Shënim: *Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta — shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: 2024 (N=13); 2025 (N=43).*

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për shkollën “Stiliano Bandilli”. Krahasimet duhen interpretuar me kujdes: në 2024 u gjurmuan vetëm 13 të diplomuar, ndërsa në 2025 u gjurmuan 46 dhe përbërja sipas drejtimeve ndryshoi ndjeshëm. Disa baza dhe përqindje kërkojnë verifikim para interpretimit.

1. Më shumë informacion për kontratat dhe sigurimet

Orientimi në karrierë të përfshijë sesione praktike për kuptimin e kontratës dhe mënyrat e verifikimit të pagesës së sigurimeve. Të diplomuarit që kanë paqartësi të orientohen drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Në 2025, raporti paraqet 46.9% të të punësuarve pa informacion nëse u paguhen sigurimet, 9.4% që deklarojnë se nuk u paguhen dhe 15.6% që punojnë pa kontratë. Baza e vlefshme e këtyre treguesve duhet sqaruar, pasi përqindjet nuk përputhen me N=43 të shënuar në raport.

2. Mbështetja për punësim të shoqërohet me kontakte konkrete

Shkolla të vijojë ndërmjetësimin për punësim dhe të ndjekë më nga afër kontaktet e të diplomuarve me bizneset. Të forcohet bashkëpunimi me zyrën e punësimit dhe të dokumentohen referimet dhe rezultatet e tyre.

Gjetja: Raporti paraqet Njësinë e Zhvillimit si kanal të gjetjes së punës së parë për 47% të të diplomuarve, por vetëm 11.6% raportojnë se shkolla i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës. Gjithashtu, 32.6% kërkojnë përmirësim të bashkëpunimit me zyrat e punësimit. Dallimi mes treguesve kërkon sqarim.

3. Të kuptohen arsyet e punësimit jashtë profesionit

Të diplomuarit që punojnë jashtë fushës së studimit të kontaktohen për të sqaruar arsyet dhe nevojat e tyre. Gjetjet të përdoren për orientimin drejt vendeve të punës në profesion ose kualifikimeve plotësuese.

Gjetja: Rreth 22% raportojnë se puna nuk lidhet me arsimin. Të 9 personat që iu përgjigjën pyetjes për arsyet kanë zgjedhur kategorinë “tjetër”, ndaj raporti nuk jep informacion të mjaftueshëm për pengesat konkrete. Ndërkohë, 32.6% dëshirojnë të gjejnë një punë në fushën e studimit.

4. Të ndiqet cilësia e punësimit krahas hyrjes në punë

Në kontaktet pas diplomimit të diskutohen mundësitë për zhvillim profesional, përparim në punë dhe përdorim të aftësive. Me bizneset partnere të identifikohen mundësi që ofrojnë detyra të lidhura me profesionin dhe perspektivë zhvillimi.

Gjetja: Raporti paraqet 59.4% të të punësuarve me të ardhura deri në 50,000 lekë, ndërsa 90.6% punojnë me kohë të plotë. Këto rezultate kërkojnë shqyrtim të kushteve dhe mundësive për përparim, pasi të verifikohen bazat e përgjigjeve. Kategoritë e ndryshme të pagave nuk lejojnë krahasim të drejtpërdrejtë me vitin 2024.

5. Mbështetje e përshtatur për vetëpunësimin

Të diplomuarve të vetëpunësuar ose të interesuar për biznes t'u ofrohet këshillim për planifikimin, menaxhimin dhe zhvillimin e aktivitetit. Fillimisht të sqarohet lloji i vetëpunësimit dhe lidhja e tij me profilin e studimit.

Gjetja: Në 2025, 24% raportohen si të vetëpunësuar dhe 28.3% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve. Kjo sugjeron nevojën për mbështetje si për aktivitetet ekzistuese, ashtu edhe për idetë e reja.